

BEQIR META

**PËRPPJEKJET PËR KONSOLIDIMIN E IDENTITETIT
KOMBËTAR NË VITET 1920-1924**

Në vitet e para të jetës kombëtare të shtetit shqiptar u kryen reforma dhe lëvizje politike shoqërore të cilat i shërbenin afirmimit e plotësimit të identitetit kombëtar të shqiptarëve.

Robert Austin, ashtu si dhe historianë të tjerë perëndimorë, është shprehur me të drejtë se “më shumë se sa fqinjët e saj, Shqipërisë i duhej të ndërtonte si kombin-shtet, ashtu dhe të forconte identitetin kombëtar, në një kohë kur situata nuk ishte aspak në favorin e saj”¹. Probleme të tilla, si mungesa e unitetit fetar, krahinor e gjuhësor, mungesa e centralizmit të përparuar dhe e modernizmit shoqëror-ekonomik, si dhe mospërhapja e plotë e idesë kombëtare në të gjithë shtresat e vegjëlisë, ishin probleme madhore që duheshin kapërcyer. Krahasuar me popujt e tjerë të Ballkanit, shqiptarëve u ishte mohuar për një kohë të gjatë përgatitja kulturore, dhe disa nga pengesat për bashkimin kombëtar ishin ende të pranishme. Ato dolën në pah veçanërisht në kuadrin e përpjekjeve për ndërtimin e shtetit².

Si vendi më i vogël, më i varfër dhe më i dobët i Ballkanit, fati i Shqipërisë u ndikua fuqimisht nga forcat jashtë kufijve të saj. Lufta për të drejtën e ekzistencës si komb-shtet, pati ndërlikime të rëndësishme pasi fqinjët e Shqipërisë përpiqeshin të nxirrnin në pah faktorët përçarës,. Ajo bëri që të harxhoheshin burime të konsiderueshme duke zhvilluar beteja politike, diplomatike e propagandistike jashtë vendit, veçanërisht në Lidhjen e Kombeve dhe në Gjykatën Ndërkombëtare, të cilat pengonin përpjekjet për konsolidimin kombëtar brenda vendit.

¹ Robert C. Austin, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit – Demokracia shqiptare në vitet 1920-1924*, “Albin”, Tiranë 2000, f. 15.

² *Po aty*, f. 20.

Si grekët, ashtu edhe jugosllavët u përpoqën t'i shfrytëzonin këto vështirësi, të shfrytëzonin dallimet fetare e krahinore në favor të politikave të tyre për të penguar afirmimin e konsolidimin e shtetit shqiptar. Ata nxitën opozitën që ta kritikonte qeverinë si qeveri myslimane që i shërbente interesave të klasës së çifligarëve myslimanë. Për qeverinë greke prania e minoritetit të vogël grek në Shqipërinë e Jugut ishte një mjet i shkëlqyer për të ruajtur presionin mbi qeverinë. Edhe jugosllavët u përpoqën të manipulonin katolikët në veri, duke e vënë theksin në mbizotërimin e parisë myslimane në Tiranë³. Por, sigurisht ata nuk neglizhuan në këtë lojë as minoritetin e vogël sllav.

Në luftën politike të viteve 1920-1924 grupe të ndryshme përdorën pakicat ose diferencat krahinore etj. për interesat e tyre të ngushta, gjë që sigurisht krijonte precedentë e impakte të dëmshme për shtetin shqiptar. Kështu, megjithëse A. Zogu u përpoq të qëndronte mbi polemikat krahinore, nuk ndenji pa shfrytëzuar armiqësinë që mbizotëronte midis pakicës greke ndaj Nolit. Duke shpresuar të kundërbalancoje ndikimin e dukshëm të Nolit në Jug, pjesa zogiste e qeverisë "po e shtrinte mbështetjen e saj tek ata kandidatë që flisnin greqisht dhe që ishin bashkuar me popullsinë greqishtfolëse". Edhe i dërguari i posaçëm grek në Durrës po përdorte ndikimin e tij në minoritet, për të siguruar votat për Zogun⁴.

Por edhe Noli në disa raste rrëshqiti në krahinorizëm, duke përkrahur interesat e Jugut mbi ato të Veriut dhe duke deklaruar në vitin 1923 se Asambleja Kushtetuese duhej të zhvendosej në Vlorë⁵. Edhe Gurakuqi bënte të njëjtën gjë kur këmbëngulte që të zhvendosej kryeqyteti në Shkodër⁶.

Problemi thelbësor që duhet mbajtur parasysh është se as Greqia dhe as Jugosllavia nuk pajtoheshin plotësisht me ekzistencën e një Shqipërie të pavarur dhe të dyja ndoqën një politikë që të pengonte konsolidimin e shtetit shqiptar. Minoritetet u përdorën si instrument i kësaj politike. Për të sfumuar pengesat në realizimin e pikësnyimeve të saj territoriale, konkretisht aneksimin e Shqipërisë së Jugut, Greqia përdori pakicën greke në Shqipëri si një mjet për të destabilizuar

³ *Po aty*, f. 46.

⁴ *Po aty*, f. 60; USNA, DS 875.00/102, Merrit-Swift për Sekretarin e Shtetit, Nr. 174, 31 tetor 1923.

⁵ *Po aty*, f. 61; *AQSh*, Fondi MPB, viti 1923, dos. 6, fl. 157.

⁶ Robert Austin, *vep. e përm.*, f. 60.

Shqipërinë dhe për të mbajtur ngjallë çështjen territoriale⁷. Qëndrimi i Greqisë ndaj përpyqjeve të Shqipërisë për të ndërtuar shtetin ishte një faktor jo i vogël në dështimet e këtyre viteve.

Ndërkohë Greqia vijonte propagandën dhe presionin kundër kishës ortodokse shqiptare. Qysh në pranverën e vitit 1919, diplomati amerikan i vendosur në Itali, Heven (Joseph Emerson Haven), në një raport të hollësishëm për gjendjen në Shqipëri pohonte se kisha greke ishte angazhuar në një varg lutjesh që synonin të frikësonin shqiptarët, duke përfshirë djegien deri në vdekje të grave dhe fëmijëve, gjymtimin, torturat dhe përdhunimin në duart e ushtarëve grekë. Ai konstatonte se në Shqipërinë e Jugut ekzistonte urrejtja dhe neveria më e fortë për Greqinë, urrejtje kjo e shfaqur si nga ortodoksët, ashtu dhe nga myslimanët. Thirrja është: “jemi së pari shqiptarë, pastaj fetarë”. Me përjashtim të pak banorëve në krahinën e Korçës dhe në pak fshatra në krahinën e Himarës, vendi është tërësisht shqiptar në ndjenjën⁸.

Guri i themelit të politikës greke, mënyrë kjo e përdorur edhe nga jugosllavët, ishte nxitja e dallimeve dhe pakënaqësive fetare në Shqipëri dhe theksimi i idesë se Shqipëria ishte një “Turqi e vogël”, armike e grekëve ortodoksë. Politikanët shqiptarë humbën shumë energji për ta kundërbalancuar këtë propagandë.

Nga perspektiva greke, Traktati i Lozanës e zmadhoi rëndësinë e bashkësisë greke në Shqipëri. Duke qenë se kishte humbur një pikëmbështetje të rëndësishme në Mesdhe, Greqia ishte akoma më e vendosur që të ruante gjurmën e fundit të një bashkësie greke në një krahinë jashtë Greqisë⁹.

Në vitin 1920 qeveria u tregua e kujdesshme me rekrutimet e ushtarëve, duke lënë përkohësisht jashtë procesit ortodoksët. Qeveria mori vendimin që përfshirja e tyre në shërbimin ushtarak të ishte fakultative dhe jo e detyrueshme, duke e justifikuar këtë qëndrim me faktin se ortodoksët nuk ishin mësuar me veprime ushtarake. Në të vërtetë nuk kishte ndonjë paragjykim të tillë për aftësitë e ortodoksëve shqiptarë dhe as për besnikërinë e tyre ndaj shtetit të ri shqiptar. Mirëpo kjo masë, e cila nisej nga qëllime të mira për të mos krijuar pakënaqësi e destabilitet, u kundërshtua nga popullsia ortodokse shqiptare, e cila

⁷ *Po aty*, f. 128.

⁸ *Po aty*.

⁹ *Po aty*, f. 135.

kërkonte të merrte pjesë aktivisht në të gjitha institucionet e shtetit shqiptar dhe të kontribuonte për mbrojtjen e tij. Në Pogradec u zhvillua një miting në të cilin ortodoksët shqiptarë i kërkuan qeverisë që t'i përfshinte në shërbimin e detyrueshëm ushtarak¹⁰.

Por edhe më parë qysh në vitin 1920, të krishterëve të qarkut të Përmetit e Leskovikut qeveria u dha armë, pas kërkesave që ata bënë për t'u veshur xhandarë e për të ruajtur vetë qetësinë në katundet e tyre. Prefekti i Gjirokastrës, Kol Tromara, që e sugjeroi këtë vendim, e konsideronte atë me rëndësi politike shumë të madhe për shtetin¹¹.

Ky qëndrim u ndryshua me vendimin e 6 janarit të vitit 1922 të MPB, e cila vendosi rekrutimin e detyrueshëm të të gjithë të krishterëve që ishin lënë jashtë atij shërbimi të shenjtë prej qeverive të mëparshme "për arsye të kohërave të shkume mjaft delikate"¹².

Një problem tjetër edhe më delikat ishte çështja e përfaqësimit politik në Parlament. Shumica e deputetëve ishin të vendosur që të bëhej gjithçka që të ruhej uniteti kombëtar në këtë fazë të parë të vështirë të konsolidimit të shtetit shqiptar. Shumica përkrahu një propozim të Ali Këlcyrës, i cili, ndonëse e pranonte se populli shqiptar kishte një ndërgjegje kombëtare, shprehte shqetësimin se mund të ndodhnin ngatërresa e përçarje. Ai sugjeroi që me vendim të Parlamentit të respektohej përbërja fetare. Pra në ato rajone ku ortodoksët ishin në shumicë të zgjidhej detyrimisht një deputet ortodoks. Ndërsa në zonat ku myslimanët ishin shumicë mund të caktohej edhe një deputet nga pakica ortodokse¹³. Më vonë Ali Këlcyra e shpjegoi kështu këtë qëndrim në Kuvendin Kushtetues: Ai theksoi se shteti shqiptar ishte afetar, por për oportunitet politik, ne propozuam që të merret si bazë në hartimin e ligjeve, proporcioni midis elementeve fetare. Arsyeja ishte se ende ngjarjet historike të së kaluarës mund të ndikonin në jetën politike, ku shumica mund të shtypte të drejtat e pakicës. Pasi shteti shqiptar nuk kishte arritur atëherë ende në shkallën e duhur të qytetërimit politik, propozuam që zgjedhjet të bëheshin në bazë të proporcionit të

¹⁰ Ortodoksët e Pogradecit protestojnë kundër vendimit të qeverisë për të mos i marrë ushtarë. "Gazet'e Korçës", 27 shtator 1920.

¹¹ MPB, viti 1920, dos.234, fl.113. Raport i prefektit të Gjirokastrës, Kol Tromara për MPB, 6 dhjetor 1920.

¹² Qarkoret e MPB të vjetit 1920, f.182. Vendim Nr.34, dt.6.1.1922.

¹³ *Bisedimet e Këshillit Kombëtar*, Legjislatura e Parë, Sesioni VI, Mbledhja XIX, Tiranë, 1923.

elementëve fetarë, për të vetmen arsye që shumica të mos mund të shkelte të drejtat e pakicës. Kjo u bë që në kohën e qeverisë së Iljaz Vrionit. Ajo pati kundërshtime të mëdha, ndërsa ne përkrahësit e kësaj vije u akuzuam si kaur e kaurofila. Kritikën më të ashpra iu bënë Mehdi Frashërit, që atëherë ishte ministër i P. Brendshme¹⁴.

Problemi i përfaqësimit në parlament u diskutua gjerësisht edhe në vitin 1923. Disa deputetë si Ali Koprencka, I. Xhindi, V. Xhuvani, N. Ivanaj kërkuan që, meqë shteti shqiptar nuk kishte fe zyrtare të mos vendoseshin proporcione në zgjedhjen e deputetëve sipas përkatësisë fetare¹⁵. Ministri i Drejtësisë M. Tutulani kundërshtoi, duke theksuar se qeveria e kishte bërë propozimin për të ruajtur përpjesëtimet midis feve në Parlament, për arsye se ajo kishte pranuar një nen në Lidhjen e Kombeve, i cili theksonte se në Parlament do të ruheshin proporcionet fetare. Qazim Koculi e kundërshtoi ashpër këtë pretendim duke theksuar se shqiptarët myslimanë e të krishterë nuk ia kishin kërkuar këtë gjë Lidhjes së Kombeve. Parashikimet e Lidhjes së Kombeve ishin vetëm për pakicat nacionale¹⁶. Ai e quajti Deklaratën në Lidhjen e Kombeve një gabim trashanik, i cili, ose duhej të ndreqej, ose do të mbetej një letër e vdekur dhe të mos zbatohet. Një argument elokuent kundër këtij propozimi dha S. Vuçiterni, i cili theksoi se ndjenjat e popullit shqiptar e bënë të panevojshme vendosjen e proporcioneve fetare në Parlament. Ai tha se në Lurë ku kishte 200 familje muhamedane dhe 3-4 familje katolike, kishin zgjedhur një krahinar të krishterë. Në Kthellë ku të gjithë ishin katolikë dhe vetëm 3-4 shtëpi myslimane, kishin zgjedhur krahinarin mysliman. Mirëpo Ali Këlcyra vijoi të këmbëngulte që proporcionaliteti të pranohej jo për hir të deklaratës në Lidhjen e Kombeve, por për interesat e vendit. Kështu u pranua propozimi që në caktimin e numrit të anëtarëve të Kuvendit Kushtetues ruhet përpjesëtimi ndërmjet feve të ndryshme¹⁷.

Për të pasur një ide më të qartë se cila ishte situata në Jug po i referohemi një promemorieje të Komitetit Mbrojtja Kombëtare -

¹⁴ *Bisedimet e Kuvendit Kushtetues*, Tiranë, 1924, Nr.8, Mbledhja XI, 14 shkurt 1924, f.173.

¹⁵ *Bisedimet e Këshillit Kombëtar*, Mbledhja XIX, 23 shtator 1923, f.1487.

¹⁶ *Po aty*, f.1497.

¹⁷ *Po aty*.

Përmet¹⁸. Në të vihej në dukje se më parë kishte ekzistuar një gjendje armiqësore midis elementit mysliman e të krishterë. Kjo buronte nga koha e Turqisë dhe ishte e nxitur nga turqit dhe Patrikana greke. Gjatë pushtimit grek në Shqipërinë e Jugut ndodhën shumë goditje e keqbërje midis elementëve që tashmë shtyheshin nga grekët. Ndërsa gjatë pushtimit italian kjo armiqësi u shtua më tepër sepse kështu ua donte interesi italianëve. Autoritetet italiane, në një rën anë shtynin myslimanët që të silleshin keq kundër të krishterëve dhe nuk i ndëshkonin aktet e dhunës që kryheshin prej individëve të veçantë myslimanë. Nga ana tjetër, me anë të agjentëve të tyre, i këshillonin të krishterët të mos bashkoheshin me "turqit!", "sepse ato janë barbarë", por të shpresonin dhe të bënin durim gjersa të vinin grekët në ato vise. Kështu që të krishterët kërkonin prova se si do të sigurohej mbrojtja e tyre, njësia, drejtësia dhe bashkëpunimi me shtetin shqiptar. Ata deklarorin me vendosmëri se nuk e mohonin kombësinë shqiptare, por shkaqet e mësipërme i shtrëngonin që të bëheshin "kombmohonjës". Elementi mysliman pasi e kuptoi rrezikun e përgjithshëm për Shqipërinë, e kupton se sot atdheu ka nevojë për një bashkim të përgjithshëm midis dy elementëve. Nacionalistët shqiptarë, të krishterë e myslimanë, vendosën të mbrojnë tërësinë tokësore të vendit dhe tashmë situata u përmirësua.

Mirëpo forca e xhandarmërisë, e cila fillimisht ishte e përbërë tërësisht nga myslimanë, bëri përshtypje të keqe dhe krijoi dyshime tek të krishterët. Menjëherë u aktivizuan të njëjtët elementë armiqësorë që kishin vepruar qysh në periudhën e pushtimit grek. Nga ana e saj Italia, sapo mori vesh se qeveria shqiptare do të dërgonte xhandarmërinë e saj, u përpoq të armatoste shumë fshatra të krishtera për t'i kundërshtuar forcat qeveritare, mirëpo dështoi sepse të krishterët nuk pranuan¹⁹.

Kishte edhe veprime individuale të ndonjë zyrtari të veçantë, të cilat shkaktonin pasoja të dëmshme. Këto ishin reminishenca të mentaliteteve të vjetra që vinin nga periudha e gjatë e sundimit osman. Kështu në maj të vitit 1921 të krishterët e Kolonjës iu ankuan qeverisë për komandantin e kufirit, Hysen bej Nikolicën, i cili kishte deklaruar në një mbledhje me parinë e të krishterëve të Kolonjës se "shumica e të krishterëve ishin

¹⁸ MPB, viti 1920, dos.5. Promemorie e Komitetit "Mbrojtja Kombëtare"-Përmet nënshkruar nga Spiro Kosova e Koço Tasi, dërguar kryeministrit Sulejman Delvina, 27 mars 1920.

¹⁹ Po aty.

tradhtarë dhe se qeveria nuk mund të kishte besim tek ky element²⁰. Ata kërkonin largimin e tij nga Kolonja.

Banorët e katundeve të Lunxhërisë, të irrituar nga turpërimi i një vajze të krishterë në Labovë dhe rrëmbimi i një tjetre në Lekël prej dy myslimanëve, bënë një mbledhje të përgjithshme dhe dërguan një komision në prefekturë, i cili i quajti këto ngjarje si fyerje kundër zakoneve të vendit dhe kundër ndërgjegjes fetare²¹. Po për këtë ngjarje paria e të krishterëve të Gjirokastrës i dërgoi një telegram proteste qeverisë, i cili u botua në gazetën "Tirana". Këtij telegrami i bëri jehonë të madhe gazeta "Kiriksi" e Janinës më 9 gusht 1924, e cila e ftoi popullin e Janinës të organizonte një miting për të shpëtuar vëllezërit "Vorioepirotë"²².

Qeveria u shqetësua shumë prej kësaj ngjarjeje dhe bëri hetime të shpejta, prej të cilave rezultoi se të dyja ngjarjet ishin shkelje ordinere të ligjit. Prokurori i Gjyqit Ushtarak të Shtettrëthimit urdhëroi arrestimin e disa personave të krishterë për propagandën e përçarjes fetare që kishin zhvilluar²³. Por zëvendësprefekti i Gjirokastrës, Koço Tasi kërkoi që këto arrestime të mos bëheshin. Ai akuzonte qeveritë e mëparshme se kishin ndjekur një politikë të ashpër, e cila kishte shkaktuar mosbesimin e elementit të krishterë në idenë kombëtare dhe kishte mbajtur të gjallë problemin epirot. Ai sugjeronte që qeveria e Nolit të ndryshonte këtë vijë, duke ndjekur një politikë më afruese ndaj elementit të krishterë, e cila do të bënte që elementi i krishterë të hiqte dorë nga proteksioni i jashtëm dhe kështu problemi epirot do të zhdukej tërësisht dhe përgjithmonë²⁴.

Një tjetër fenomen ishte përballja me propagandën greke, e cila nxiste dyshime dhe ftohtësi midis popullsisë ortodokse shqiptare. Kështu nxiteshin djemtë ortodoksë që të arratiseshin në Greqi. Ky fenomen ishte vërejtur në qarkun e Përmetit, ku disa propagandistë të të huajve e kishin nxitur këtë arrati. Njëri prej këtyre propagandistëve, Mantho Buxhuku, iu dorëzua Gjyqit, ndërsa më vonë djemtë e arratisur filluan të kthehen në

²⁰ *MPB*, viti 1921, dos.277, fl.41. Ankesë e të krishterëve të Kolonjës dërguar Parlamentit, Këshillit të Ministrave dhe *MPB*, 27 maj 1921.

²¹ *MPB*, viti 1924, dos.77, fl.5. Prefektura e Gjirokastrës-*MPB*.

²² *Po aty*.

²³ *Po aty*, f.39.

²⁴ *Po aty*, fl.47. Zv/prefekti i Gjirokastrës, Koço Tasi-*MPB*, 21 gusht 1924.

vendin e tyre, "të dëshpëruar nga lodra e poshtër që u luajt në kurrizin e tyre". Qeveria i priti me kujdes dhe ngrohtësi këta njerëz të mashtruar²⁵.

Rezultat i gjendjes së krijuar në vend ishte edhe memorandum i të krishterëve të Korçës²⁶. Memorandumi i deformonte shkaqet e vështirësive të konsolidimit të shtetit shqiptar. Ai theksonte se ky shtet "që kurse u njoh nga Konferenca e Londrës si një shtet neutral, nuk u largua kurrësi nga mënyra e qeverimit oriental të Turqisë, e kështu shkaktoi shumë herë rreziqe të jetës politike e kombëtare të shtetit tonë, dhe duke parë se gjithë kjo mënyrë qeverimi është duke vazhduar... gjë e cila sigurisht i sjell vdekjen kombit, për ta shpëtuar këtë nga rreziqet e sigurta, vendosëm të mos marrim pjesë në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare...".

Në hyrje të këtij memorandum qeverisja e centralizuar paraqitej si një e keqe e madhe "që kishte sjellë gjithmonë edhe në shtetet më homogjene shkatërrimin e tyre, ndërsa decentralizimi paraqitej si faktor i përparimit dhe i qytetërimit i aplikuar në të gjitha shtetet e përparuara dhe "si i vetmi mjet që do të siguronte bashkimin kombëtar të vërtetë dhe jo sipërfaqësor". Argumenti themelor dhe i veçantë ishte se "kombi shqiptar, vërtet ishte një komb homogjen, porse ndryshimi i fesë dhe i kulturës e kanë ndarë në dy konventa zakonesh dhe qytetërimi të ndryshëm, e kështu nuk është kurrësi e mundur që të vijë bashkimi i vërtetë dhe përparimi i kombit shqiptar derisa sundimi i krahinës së Shqipërisë Jugore të ishte në dorë të muhamedanëve, të cilët, për arsye të kulturës orientale e kishin tepër të vështirë që të adoptonin qytetërimin oksidental". Si një argument i dytë paraqitej afërsia gjeografike e Shqipërisë Jugore me Greqinë, e cila konsiderohej një shtet i përparuar. Për këtë arsye thuhej se interesat politike kërkonin që kjo krahinë të kishte një "administratë të mbaruar europiane" e në këtë mënyrë do të zhdukeshin vetvetiu ato qëllime politike të trashëguara prej qeverimit të tiranisë turke e të sigurohej jeta politike e kombit dhe e shtetit shqiptar.

Programi përbëhej nga këto kërkesa:

1. Shqipëria Jugore të kishte një administratë të veçantë, të administrohej prej një guvernatori të përgjithshëm dhe një këshilli departamentar. Guvernatori i Përgjithshëm do të zgjidhej me shumicën e

²⁵ AQSH, Fondi, MPB, viti 1920, dos.234, fl.67. Raport i Prefekturës së Gjirokastrës-MPB, 20 shtator 1920.

²⁶ Memorandumi i të Krishterëve Shqiptarë. "Gazet'e Korçës", 19 shkurt 1921.

votave të gjymtyrëve të këshillës departamentare dhe do të aprovohej prej qeverisë qendrore. Këshilla departamentare, që do të zinte vendin e një parlamenti, do të përbëhej prej një numri të caktuar këshilltarësh, të cilët do të zgjidheshin me vota të drejtpërdrejta të popullit dhe do të përbëhej në 2/3 nga të krishterë dhe 1/3 muhamedanë. Këshilli kishte të drejtë të diskutonte mbi gjithë çështjet e krahinës, ekonomike, administrative, arsimore e gjyqësore dhe do të miratonte ligjet e nevojshme. Të gjithë nëpunësit e krahinës do të emëroheshin nga guvernatori i përgjithshëm dhe do të aprovohej prej qeverisë qendrore. Të ardhurat e krahinës do të shpenzoheshin të gjitha për nevojat e saj. Do të hiqej një pjesë e vogël në proporcion me krahinat e tjera për shpenzimet e politikës së jashtme, Parlamentin qendror etj., që do t'i jepej qeverisë qendrore. Këshilli do të kishte të drejtë që të caktonte organizatorët e huaj për të gjithë degët e administratës, me qëllim që krahinës t'i jepej një pamje europiane, e cila do të bëhej model edhe për krahinat e tjera të Shqipërisë. Do të mbahej një xhandarmëri e mjaftueshme vetëm për të siguruar qetësinë e vendit pasi shteti shqiptar ishte njohur që në fillim si neutral. Nëpunësit dhe pjesëtarët e xhandarmërisë do të ishin 75% të krishterë dhe 25% muhamedanë, derisa të bëhej një transformim i kombit dhe të ishte zhdukur mentaliteti oriental dhe nuk do të ishte më e nevojshme ruajtja e këtij raporti. Zëdhënëse e pikëpamjeve të memorandumistëve u bë atëherë Gazeta e Korçës. Ajo e vinte theksin në kritikën e ashpër e tendencioze ndaj "politikave orientale" të qeverisë, shkruante kundër sundimit e privilegjeve të bejlerëve të mëdhenj, kundër ndalimit të krishterëve për të shkuar ushtarë dhe trajtimin të tyre si pakicë, kritikonte trajtimin e keq të emigrantëve shqiptarë të Amerikës etj. Gazeta dënonte shtypjen e "bujqve të krishterë" në Myzeqe nga Vrionasit e Resulët etj.²⁷ Gazeta kritikoi ashpër zbatimin e ligjit për fajet politike nga Qeveria, dhe e cilësoi atë si një përpjekje të qeverisë për t'i mbyllur gojën kritikave kundër saj²⁸.

Qeveria u përpoq ta shmangte me kujdes debatin dhe konfliktin me memorandumistët. Ajo u përgjigj se kërkesat e tyre mund t'i diskutonte vetëm Parlamenti, ndërsa qeveria nuk kishte asnjë kompetencë që t'i diskutojë ato. Ajo kërcënoi se, për ato persona që do të vijonin të tilla

²⁷ *Ku është njësia e vërtetë*, "Gazet'e Korçës", 5 mars 1921.

²⁸ *Çpallja e gjyqit politik*, "Gazet'e Korçës", 16 mars 1921.

propaganda dhe që donin të mbillnin farën e grindjes në mes popullit, do të merreshin masa ligjore dhe do të burgoseshin²⁹.

Sulmin kundër memorandumit e zhvilloi i gjithë shtypi shqiptar. Një pozicion më të moderuar mori gazeta "Mbrojtja Kombëtare". Ajo shkruante se promemoria e të krishterëve të Korçës i kishte bërë shumë bashkatdhetarë që të dridheshin përpara fatit të atdheut, i cili ende nuk është vendosur plotësisht. Ai u erdhi si një rrufe e papritur". Gazeta bënte thirrje që problemi të diskutohej me gjakftohtësi, me një gjuhë logjike në bazë të atdhetarizmit dhe të diturisë, të mbështetur në parime shkencore e historike³⁰. Paralajmëronte se, në të kundërt, po të vepronte ndjesia në vend të logjikës, intriga e lakmia në vend të atdhetarizmit, padituria në vend të dijes, qejfi ose inati në vend të fakteve historike, atëherë padyshim memorandumit i të krishterëve të Korçës do të ishte një "rrufe në kulmin e atdheut dhe kështu do të shkaktojë ruajna o zot, fikjen dhe rrënimin e tij"³¹. Memorandumit konsiderohej veçanërisht i rrezikshëm për momentin kur ishte publikuar, sepse vendi ishte në një periudhë prove për mundësinë e vetëqeverisjes dhe funksionimit normal të shtetit shqiptar, kështu që vetëm gjakftohtësia dhe urtësia shërbenin, në mënyrë që shqiptarët t'i tregonin botës së qytetëruar me vepra se meritonin të jetonin si një komb i lirë dhe i bashkuar³².

Memorandumit i korçarëve për decentralizimin e shtetit shqiptar u vlerësua se i kishte themelet në det, pasi shumica e shqiptarëve të krishterë e hodhi poshtë atë. Duke bërë paralele me Lëvizjen Vorioepirote të vitit 1914, gazeta shkruante se "ajo nuk ishte e drejtuar kundrejt ndonjë mbreti muhamedan, sepse në atë kohë kur Shqipëria po ngrihesh në këmbë me mbret e me organizatorë europianë, vepra e Zografos polli kryengritjen e Shijakut, sepse Zografi me Esatin i binin një teli"³³. Seid Kemal shkruante se "nacionalistët shqiptarë nuk e mohojnë se administrata e shtetit tash për tash, kundra dëshirës së tyre, vazhdon e kalbet, por ata derëzëzë kanë arsye të kërkojnë një përkrahje të fortë prej

²⁹ Qarkoret e MPB të vitit 1920, f.11. Telegram i MPB-Prefekturave, 26.2.1921; AQSH, Fondi, MPB, viti 1921, dos.45, fl.10. Vendim i Këshillit të Ministrave nr.191, datë 23 shkurt 1921.

³⁰ *Me gjak të ftohtë!* "Mbrojtja Kombëtare", Vlorë, 4 mars 1921.

³¹ *Po aty.*

³² *Po aty.*

³³ Seid Kemal, *Ç'qëndrimi*, "Mbrojtja Kombëtare", Vlorë, 7 mars 1921.

gjithë nacionalistëve të krishterë, dhe jo t'u hidhet ferra ndër këmbë nga ana e disave prej tyre"³⁴.

Gazeta "Drita" e Gjirokastrës ribotonte një artikull të gazetës "Dielli" në të cilin thuhej se memorandumimi "po hidhte një farë të rrezikshme përçarje midis elementëve të Shqipërisë, gjë e cila ishte mjeti më i mirë për të shkatërruar e për të rrëzuar këtë godinë që mezi është ngritur dhe ka mbetur pa mbaruar nga ndalimet që kanë nxjerrë përpara njerëz si obstruktionistët e Korçës. Preferenca e elementëve të Shqipërisë ka qenë mjeti kryesor i armiqve të atdheut për përçarjen, sepse e kanë ditur se kudo çështja e fesë është delikate. Kjo ka qenë puna e Austrisë në Shkodër, kështu ka vepruar Greqia dhe Italia në Shqipërinë e Jugut"³⁵. Gazeta nënvizonte se, kështu, shqiptarët ekspozoheshin në sytë e botës se nuk mund të rronin në harmoni e kërkojnë të ndahen nga njëri-tjetri. Kështu "i lyejmë me gjalpë bukën armikut dhe i japim atij në dorë një dokument më të fortë për të justifikuar kërkesat që kanë grekët" dhe, për fat të keq, ky dokument "ka nënshkrimin e patriotëve të sprovuar". Më tej artikulli konkludonte: "Neve nga ana jonë nuk shohim asnjë ndryshim midis propagandës antikombëtare të lal Dervishit më 1914 dhe të një pakice korçarësh që përdorin fenë për të arritur qëllimin e atyre që i kanë bërë vegla të verbra"³⁶.

Nga ana tjetër, nga të gjitha krahinat e Shqipërisë, popullsia e të gjitha besimeve e denoncoi memorandumimin si një vepër të dëmshme e të rrezikshme për atdheun³⁷.

Fillimisht qeveria urdhëroi burgosjen e autorëve të memorandumimit. Më pas MPB e udhëzoi Prefekturën e Korçës që ata të mos dërgoheshin në gjyq, por të punohej me ta që të tërhiqnin memorandumimin³⁸.

Për ta qetësuar situatën qeveria emëroi Nikollaq Zoin prefekt, Nik Dishnicën (Kryetari i Federatës "Vatra" - Korçë) drejtor policie dhe Stefanaq Plumbin drejtor poste³⁹. Prefekti i Korçës, Zoi ishte këmbëngulës në mbajtjen e një qëndrimi të moderuar dhe u përpoq që autorët e memorandumimit ta tërhiqnin e ta përgënjeshtonin atë ose, të paktën, të përçaheshin. Mirëpo ai nuk pati sukses. Ai informonte MPB se

³⁴ *Po aty*.

³⁵ *Rreth Memorandes, "Drita", Gjirokastrë, 10 mars 1921.*

³⁶ *Po aty*.

³⁷ *AQSH, Fondi MPB, viti 1921, dos.45, fl.9.*

³⁸ *Po aty, fl.72. MPB-Prefekturës Korçë, 17 shkurt 1921.*

³⁹ *Çështja e Korçës, Gazet'e Korçës, 19 mars 1921.*

mirëkuptimi me autorët e memorandumit kishte qenë i pamundur. Megjithatë ai kërkonte që të mos merreshin masa shtrënguese pasi mbështetësit e memorandumit kishin mbetur në pakicë dhe në opinionin e popullit quheshin vegla të të huajve. Ata kishin pak mbështetës që kishin ardhur nga Amerika. Për këtë arsye çështja u diskutua me F. Nolin, i cili sugjeroi që prej atdhetarëve shqiptarë të Amerikës të dërgohej në Korçë At Vasil Marku⁴⁰. Mirëpo MPB vijonte të këmbëngulte që Kol Rrodhe, Koço Kotta, Llambi Bimbli e Milto Gurra, të cilët konsideroheshin si autorët kryesorë të memorandumit, të arrestoheshin e të dërgoheshin në Elbasan për t'u gjykuar, pasi ata po e shtrinin propagandën e tyre përtej qarkut të Korçës⁴¹. Zoi vijonte të kundërshtonte, duke bërë të qartë se, po të merreshin masa të forta kundër tyre, do të shkaktohej një zemërim i dëmshëm në popull. "Ata kështu po ç'nderohen, - njoftonte ai, - dhe zënia e tyre mund t'i nderojë duke krijuar përshtypjen se i jepet rëndësi punës së tyre. Mund të egërsohen ato pak shokë të tyre me të cilët jemi në marrëveshje me anë të Vasil Markos. Ne me F. Nolin do t'i shkëpusim këta prej tyre dhe kështu grupi i lartpërmendur do të mbetet shkaktari i vetëm i tradhtisë". Pra, ai kërkonte që të pritej rezultati i këtij veprimi pastaj të kryhej arrestimi. MPB e pranoi këtë mendim⁴².

Disa muaj më vonë, Prefektura e Korçës informoi qeverinë se kishte disa ditë që ishte konstatuar një bashkëpunim midis grekomanëve, memorandumistëve dhe 3-4 bejlerëve, me qëllim që të rrëzonin qeveritarët lokalë, prefektin, kryegjyqtarin, prokurorin etj.⁴³

Ashtu siç pritej, memorandumimi i dha shkas intensifikimit të presionit grek kundër Shqipërisë. Qeveria greke protestoi në Lidhjen e Kombeve se qeveria shqiptare po merrte masa ndëshkimore kundër banorëve të Korçës që kishin nënshkruar memorandumimin dhe se autoritetet shqiptare po merrnin me dhunë firmat në Himarë për t'i dërguar një memorandum Lidhjes së Kombeve⁴⁴. Akuza të ngjashme kishte bërë më parë edhe Lidhja Epirote e Pireut. Qeveria shqiptare e informoi Lidhjen e Kombeve se çështja e Korçës kishte lindur pas

⁴⁰ *AQSH*, Fondi, *MPB*, viti 1921, dos.45, fl.75. Prefekti i Korçës, Zoi-MPB, 21 mars 1921.

⁴¹ *Po aty*, fl.80. MPB-Prefekturës Korçës.

⁴² *Po aty*. Prefekti i Korçës, Zoi-MPB, 25 mars 1921.

⁴³ *Po aty*, fl.136. Prefektura e Korçës-Kryeministrisë, 10 gusht 1921.

⁴⁴ *AMPJ*, viti 1921, dos.88, fl.89-91. Qeveria greke-Lidhjes së Kombeve, 24 shtator 1921.

celebrimit të pashkëve nga ortodoksët shqiptarë në gjuhën shqipe dhe se nuk kishte pasur as kundërshtime, e as rezistencë dhe rrjedhimisht as viktima siç kishte pretenduar Lidhja Epirote dhe se persekutimi, dhuna dhe masakrat ndaj popullsisë në Shqipërinë e Jugut ekzistonin vetëm në imagjinatën e njerëzve të Pireut⁴⁵. Disa ditë më vonë, kryeministri I. Vrioni i relatoi Lidhjes së Kombeve se memorandumi i Korçës, shprehte disa pikëpamje ekstreme, megjithëse autorët e tij nuk ishin antipatriotë. Ai vinte në dukje se kishte edhe dokumente të tjera të ortodoksëve shqiptarë të cilët pasqyronin opinione të ndryshme nga memorandumi. Gjithashtu thuhej se memorandumi kërkonte decentralizimin, por asnjëherë nuk e përmendte fjalën independencë siç pretendonte Kassavates. Megjithëse cilësoheshin si ekstremistë, autorët e memorandumit vlerësoheshin si "patriotë të vërtetë të cilët kishin luftuar me devocion kundër pushtimit të përkohshëm të rajonit të tyre nga Greqia"⁴⁶. Vrioni e cilësoonte memorandumin si "një formulë që i ishte paraqitur administratës qendrore për të modernizuar administratën në provincat e Jugut dhe nuk bënte aluzion për pavarësi". Kështu interpretimi i Cassavates ishte tërësisht fals⁴⁷.

Duke përfituar nga kjo situatë, ish anëtarët e "Qeverisë Vorio Epirote" të vitit 1914, M.D. Doulis dhe Basile (gjithashtu ish Mitropolit i Gjirokastrës) kërkuan bashkimin e Vorio Epirit me Greqinë⁴⁸.

Në vitin 1923 u ndërmor një veprim tjetër separatist nga një grup shqiptarësh të krishterë të Stambollit, të cilët më 9 maj 1923 i paraqitën Lidhjes së Kombeve një kërkesë për ndarjen e Shqipërisë në kantone. Reaguan ashpër kundër kësaj kërkesë përfaqësuesit e popullsisë katolike të Shkodrës, të cilët e refuzuan atë me përbuzje dhe në mënyrë kategorike. Gjithashtu reaguan edhe deputetët katolikë, të cilët i dërguan një letër Lidhjes së Kombeve⁴⁹. Edhe popullsia e krishterë e Delvinës

⁴⁵ *Po aty*, fl.11. MP Jashtme Mehdi Frashëri-Sekretarit të LK, Vlorë, 5 qershor 1921.

⁴⁶ *Po aty*. Kryeministri Iljaz Vrioni-Lidhjes së Kombeve, 26 qershor 1921.

⁴⁷ *Po aty*.

⁴⁸ *Po aty*, fl.98-101. Apel i M.D. Doulis dhe i Mitropolitit të Gjirokastrës, Basile-Lidhjes së Kombeve, 4 tetor 1921.

⁴⁹ *AMPJ*, viti 1923, dos.87; dos.355. Letër e deputetëve të Shkodrës-Lidhjes së Kombeve, 8 korrik 1923.

kundërshtoi ndarjen e Shqipërisë në kantone, me anë të një telegrami që i dërgoi Lidhjes së Kombeve⁵⁰.

Por jo gjithçka ishte në favor të konsolidimit të shtetit dhe kombit shqiptar. E kaluara ende shkaktonte dyshime e pasiguri. Kështu pas disfatës së ushtrive greke në Lindje, një pjesë e parisë së krishterë të Prefekturës së Vlorës, të njohur edhe më parë për qëndrime antikombëtare, duke e humbur shpresën për një bashkim me Greqinë, kishin filluar të bashkëpunonin me konsullin italian të Vlorës "për të siguruar, herët e vonë, njëfarë proteksioni italian nën maskën e krishterimit e ndoshta në formë minoriteti"⁵¹.

Lëvizja për mbylljen e shkollave të huaja

Pjesë e lëvizjes që po zhvillohej në vend për unifikimin kombëtar ishte edhe lëvizja për mbylljen e shkollave të huaja dhe formimin e arsimit kombëtar. Gazetat "Koha" dhe "Posta" e Korçës e ngritën me forcë këtë problem dhe i bënë presion qeverisë të merrte masa të shpejta. "Koha" akuzoi dhespot Jakovin se ai po zhvillonte një propagandë dhe po bënte presion të madh që të ruheshin shkollat greke në Korçë dhe po pengojë hapja e shkollave shqipe. "Koha" shkruante: "Shkollat janë tonat, ne i kemi ndërtuar. Gjer dje kur nuk kishim shtet, kishim një komunitet (komunitet) dhe qenë të saj. Sot, meqenëse kemi një shtet, janë të shtetit. Shteti lypset t'i mbyllë shkollat e propagandës. Populli sot me një zë thërret kundër kësaj padrejtësie dhe kërkon drejtësi nga qeveria e tij. Ai ka shpresën e madhe se zëri i tij do të dëgjohet dhe që sot e tutje nuk do të ketë më shkolla greqisht si këtu në qarkun e Korçës, ashtu edhe në viset e tjera të Shqipërisë"⁵². Mbyllja e shkollave greke dhe çelja e shkollave shqipe vlerësohej si një e drejtë të cilën e ushtronte e gjithë bota e qytetëruar, ku çdo popull kishte të drejtë të arsimonte brezin e ri në gjuhën amtare.

Në vitin 1921 shumë fshatra të Korçës, që kishin pasur shkolla greke, pas thirrjes që u bë në shtyp dhe me këshillat miqësore të autoriteteve shtetërore të Korçës, kërkuan vetë hapjen e shkollave shqipe.

⁵⁰ *Po aty*, fl.5-10. Telegram i popullsisë së krishterë të Delvinës-Lidhjes së Kombeve, 17 korrik 1923.

⁵¹ *AQSh*, Fondi MPB, viti 1923, dos.97, fl.2. Prefektura Vlorë-MPB, 25 janar 1923.

⁵² *Jakovi dhe shkollat greqisht*, "Koha", Korçë, 3 shtator 1921.

Ndërsa dhespoti i Korçës po përpiqej të hapte shkolla greke në qytetin e Korçës, me synimin që kjo të dekurajonte lëvizjen për shkollën shqipe⁵³.

Një tablo interesante mbi problemin e identitetit kombëtar të shqiptarëve jep dhe raporti i Komisionit Hetimor të LK⁵⁴. Ky Komision relatonte se midis popullsisë së krishterë të Shqipërisë së Jugut kishte një pakënaqësi të fortë, e cila një vit më parë konstatohet më shumë midis atyre që kishin studiuar në Greqi, ndërsa tani ishte përhapur edhe midis nacionalistëve [shqiptarë] të qarkut të Korçës. Si shkak kryesor të kësaj pakënaqësie Komisioni veçonte vështirësitë financiare, pasi sipas tij, Korça, ashtu si dhe Gjirokastra, paguanin një proporcion të madh të taksave të shtetit shqiptar, ndërsa mundësitë për të fituar të holla ishin pakësuar. Tregtarët e Korçës, dikur nxirrnin fitime të konsiderueshme në tregtinë me Selanikun, rrugë e cila tani ishte e mbyllur, ashtu siç ishte vështirësuar trafiku me Manastirin. Kishte humbur gjithashtu rëndësia e shkëmbimeve ekonomike me emigrantët që ktheheshin nga Amerika.

Taksat dhe tagrat doganore që rëndonin mbi produktet e nevojshme të jetesës, si: mishi, kripa dhe sheqeri ishin shumë të larta dhe të krishterët ankoheshin se këto detyrime ishin më të rënda mbi mallrat që përdreshin prej të krishterëve se sa prej myslimanëve. Sillej një shembull, i cili ngjante disi qesharak, ku taksa e një kapeleje me strehë taksohej 10 herë më shumë se sa një feste e cila ishte bërë prej të njëjtit material, por vetëm nuk kishte strehë. Moratoriumi që zbatohet vetëm në qarkun e Korçës që prej shumë vitesh, propagandohej se ishte në dobi të pronarëve myslimanë, të cilët ishin më së shumti borxhlinj, dhe në dëm të tregtarëve të krishterë të cilët kishin për të marrë borxhin.

Prefekturat e Korçës dhe Gjirokastrës që thuhej se kishin paguar pjesën më të madhe të buxhetit shtetëror të Shqipërisë, kanë përfituar vetëm një pjesë të vogël të këtyre shumave të derdhura, pasi pjesa më e madhe ishte përdorur për të paguar administratën qendrore në Tiranë, ushtrinë, si dhe shpenzimet për të shtypur kryengritjet etj.

Për këtë çështje vërehej njëfarë deziluzioni politik i nacionalistëve të Korçës, të cilët shpresonin se, me pavarësinë e Shqipërisë, do të krijohet një shtet i ri, i cili qysh në fillim do të ishte ndryshe nga ç'kishte

⁵³ *AQSh*, Fondi MPB, viti 1921, dos.714, fl.21. Prefektura Korçë-MPB, 23 nëntor 1921.

⁵⁴ *AMPJ*, viti 1923, dos.211, fl.3-31. Raport i Komisionit Hetimor të LK mbi veprimtarinë në Shqipëri gjatë periudhës 19 dhjetor 1922-1 shkurt 1923.

qenë një vilajet turk. Pra vështirësitë kishin qenë më të mëdha se ç'priteshin dhe optimistët u zhgënjyen në shpresat e tyre.

Banorët e Shqipërisë së Jugut mendonin se duhej të kishin më shumë influencë në çështjet shtetërore, e cila do të ishte në proporcion me kulturën dhe me rëndësinë ekonomike të prefekturave të tyre. Komisioni Hetimor kishte marrë ankesa se ish nëpunësit e Turqisë nga Gjirokastra, më së shumti muhamedanë, kishin zënë punë në Tiranë dhe në vise të tjera të Shqipërisë, ndërsa të krishterët e Jugut kishin më pak peshë në punët e shtetit se sa muhamedanët dhe katolikët. Komisioni e shpjegonte këtë situatë me faktin se një pjesë e ortodoksëve që ishin grekofilë, të cilët ende mund të shpresonin se statusi politik i prefekturave të tyre mund të ndryshohej, natyrisht ishin vetpërrjashtuar nga çdo pjesëmarrje në politikën shqiptare. Por Komisioni konstatonte se edhe ortodoksët nacionalistë shqiptarë kishin mbetur larg nga jeta publike më tepër se sa ç'ishte e dëshirueshme. Ai e argumentonte këtë me faktin se shumë pak të krishterë të Korçës kishin marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare të vitit 1921. Në qytetin e Korçës nga 7 000-8 000 votues të krishterë, kishin marrë pjesë në zgjedhje vetëm 220 vetë. Komisioni veçonte si shembull pozitiv të pjesëmarrjes në jetën politike e publike të vendit, vetëm të krishterët që ishin anëtarë ose nën ndikimin e Shoqërisë Patriotike "Vatra".

Ortodoksët e Jugut ishin ankuar se ndarja e qarqeve elektorale nuk ishte në favorin e tyre. Konkretisht për qarkun e Himarës, e cila kishte qenë më parë një njësi me Prefekturën e Gjirokastrës, ishte bashkuar me Prefekturën e Vlorës në të cilën kishte 28 000 myslimanë dhe 13 000 të krishterë. Prefektura e Korçës, e cila përfshinte dhe Pogradecin, kishte tani një shumicë të madhe myslimane, 72 000 kundrejt 48 000 të krishterëve.

Komisioni theksonte se qeveria shqiptare e kishte bërë të qartë kurdoherë se përpjesëtimi midis nëpunësve të krishterë e myslimanë, proporcionalisht ishte në favor të të krishterëve. Mirëpo ai kishte dëgjuar zëra nga disa të krishterë në Shqipërinë e Jugut se zyrtarët e krishterë që emëroheshin prej qeverisë, ishin më tepër ata që kishin besimin e muhamedanëve dhe jo atë të bashkëfetarëve të tyre. Komisionit i ishin servirur disa shembuj, kur nëpunës të krishterë ishin zëvendësuar me muhamedanë, si për shembull disa mjekë të spitalit të Korçës, që kishin studiuar në Athinë ishin zëvendësuar me mjekë myslimanë që kishin

studiuar në Stamboll. Gjithashtu kishte disa gjykatës të periudhës turke që ruanin pozitat e tyre.

Komisioni raportonte se një ankesë e zakonshme ishte se drejtësia midis myslimanëve dhe të krishterëve nuk zbatohet në mënyrë të njëjtë. Nëpunës të krishterë i kishin thënë Komisionit se muhamedanët nuk i bindeshin ligjit, dhe disa nëpunës muhamedanë në disa raste kishin penguar zbatimin e tij, sepse dëmtoheshin disa nga miqtë e tyre.

Sipas Komisionit drejtësia mungonte, veçanërisht në çështjen e pronave tokësore. Pronarët bejlerë që janë myslimanë përpiqeshin të zgjeronin pasuritë e tyre mbi tokat e disa fshatarëve të krishterë, të cilët i quanin të tyre, ose pengonin kullotjen e tufave të bagëtive të të krishterëve në kullotat e pronarëve myslimanë. Komisioni konkludonte se reforma agrare ishte e domosdoshme, dhe kryerja e saj do të ndikonte pozitivisht në kapërcimin e përçarjes fetare.

Por pavarësisht nga këto ankesa, Komisioni Hetimor arrinte në përfundimin se gjendja e drejtësisë nuk ishte më e keqe se sa në shumicën e vendeve të Ballkanit, dhe se në shumë raste të krishterët shqiptarë dhe minoritarët grekofonë kishin deklaruar sinqerisht se ishin shumë të kënaqur me qetësinë publike. Komisioni theksonte se sigurimi publik i brendshëm në dy vitet e fundit kishte bërë me të vërtetë përparime të mëdha në krahasim me periudhën e sundimit turk.

Kaq i vështirë kishte qenë regjimi turk për popullsinë e krishterë saqë çdo padrejtësi zgjonte kujtimet e kohës së shkuar dhe frikën se mos shfaqej prapë. "Mosbesimi që kanë të krishterët për myslimanët zuri rrënjë në shekujt e shtërngimit dhe nuk do të zhduket para se të ndryshohet i tërë sistemi" - theksohej në raportin e Komisionit Hetimor. Këto ndjenja sipas tij nuk ishin kundër fesë myslimane, por ato lidheshin vetëm me faktin se feja në kohën e Turqisë caktonte të drejtat e zotëve dhe të rajave.

Komisioni konstatonte se fatmirësisht midis myslimanëve të Jugut kishte shumë pak fanatizëm. Këta ishin më së shumti bektashinj, "një sekt feje të ndriçuar, pak skeptikë dhe shumë tolerantë me fetë e tjera". "Në qoftë se myslimanët e Jugut kanë ndonjë ndjenjë kundër të krishterëve, kjo mund të përshkruhet më tepër si një ndjenjë epërsie ndaj tyre se sa fanatizëm fetar".

Madje raporti vinte në dukje se "në disa raste fanatizma më e madhe kishte qenë midis të krishterëve. Gërmadhat e qindra shtëpive të djegur në kohën e qeverisë së Zografos në vitin 1914, ishin shenja të

helmuara të hakmarrjes nga ana e të krishterëve për të ligat që u kishin bërë më përpara". Komisioni pohonte se vërtetë forca kryesore ushtarake kishte qenë ushtria greke "por kishte pasur shumë të krishterë nga Epiri i Veriut, të cilët me dëshirë ose me pahir, morën pjesë në luftë si dhe në keqbërjet".

Komisioni relatonte se "pasionet janë akoma të fortë që mund të përsëriten në çdo kohë, në qoftë se nuk largohen përpjekjet e reja. Një pajtim midis të krishterëve dhe myslimanëve, të cilët formojnë dy pjesë të mëdha të popullit të Shqipërisë së Jugut, është një nevojë absolute për mirësinë e atij qarku".

Komisioni arrinte në përfundimin se "ndjenjat grekofile të shumicës së popullit ortodoks të Shqipërisë Jugore nuk mund të përshkruhen si nacionalizma greke. Midis më të fortëve grekofilë, dhe madje edhe midis atyre që ishin vendosur në Greqi dhe shumë herë kanë luftuar për të, u ka mbetur një ndjenjë e fortë në favorin e Shqipërisë, megjithëse preferojnë ta quajnë Epir të Veriut dhe jo Shqipëria e Jugut dhe janë fodullë, meqë janë nga raca shqiptare. Ndjenjat e tyre për Greqinë nuk janë "irredente", por ndjenja për një shtet, i cili ka qenë burimi i kulturës së tyre, dhe armiku i regjimit të urryer turk. Pakënaqësia e sotme më tepër vjen nga shkaqet ekonomike". Në qoftë se bëhen lëvizje kryengritëse, këto mund të nisen nga ana tjetër e kufijve, ku ndodhen disa organizata panepirote, të cilat kanë deklaruar qartë se do të zaptojnë Epirin e Veriut për Greqinë. Komisioni pohonte se në bazë të ligjit ndërkombëtar, qeveria greke duhej të ndalonte këto lëvizje dhe këto organizata.

Shkaqet kryesore të ndjenjave antimuslimane të disa të krishterëve të Shqipërisë së Jugut, Komisioni i cilësonte si shkaqe historike dhe sociale, të cilat mund të përshkruheshin si ndjenja kundër çdo mbeturine reale apo imagjinare të regjimit të vjetër turk të shtrëngimit. Komisioni sugjeronte se "vetëm duke krijuar një Shqipëri të ndryshuar me institucione dhe me administratë jo më pak cilësore se të shteteve fqinj, do të ishte e mundur të fitoheshin zemrat e të krishterëve dhe të sigurohej bindja e tyre e plotë tek Shqipëria". Ndërsa masat shtrënguese vetëm do t'i largonin ata. Komisioni veçonte si një politikë të gabuar ndalimin e njerëzve për të emigruar në Amerikë e gjetkë, dhe e cilësonte këtë ndalim, në kundërshtim me parimin e lirisë së plotë për pakicat.

Komisioni Hetimor theksonte se ishte e zorshme të besohej se populli muhamedan i Jugut, më tolerant dhe më i stërvitur se gjetkë, do t'i

kundërshtonte reformat. Ai rekomandonte një lloj autonomie lokale për prefekturat e Jugut, dhe çka ishte më e rëndësishme lidhjen e tyre me pjesët e tjera të vendit me komunikacione më të mira, të cilat do të shtonin lidhjet e tyre me vendin dhe do të rrisnin tregtinë. "Çdo gjë që ndihmon në bashkimin e Shqipërisë ka një rëndësi vitale", thuhej në raport.

Komisioni konstatonte me kënaqësi gjithashtu se programi i qeverisë ishte në drejtimin e duhur për reformimin e vendit dhe për shndërrimin në një shtet modern.

Ballafaqimi me politikën greke për Sarandën

Në vijim të përpjekjeve të saj për të zgjeruar arealin e minoritetit grek, qeveria e Athinës bëri përpjekje të mëdha që të përfshinte në këtë zonë edhe Sarandën. Kjo solli ballafaqimin me qeverinë shqiptare.

Në periudhën e fundit të sundimit osman, Saranda kishte qenë një qytet i pazhvilluar që banohej në shumicë nga një popullsi shqiptare. Mirëpo duke përfutuar nga rrethanat e Luftës I Botërore, qeveria greke me anë të agentëve të saj, u përpoq të fuste në dorë disa objekte me rëndësi tregtare të Sarandës.

Një nga këta objekte ishin edhe barakat e ushtrisë italiane në qendër të qytetit. Në kohën kur do të lëshonte Sarandën, ushtria italiane kishte marrë urdhër që të mos i shiste qeverisë shqiptare asnjë nga objektet që nuk kishte mundësi t'i merrte me vete. Mirëpo, Prefektura e Gjirokastrës dha urdhër që asnjë njeri nuk do të blinte materiale nga ushtria italiane, dhe veçanërisht barakat, sepse qeveria shqiptare nuk do ta njihje si legale këtë blerje⁵⁵. Pas këtij vendimi komanda italiane u shtrëngua t'ia shiste barakat prefekturës së Gjirokastrës sipas një çmimi të përcaktuar nga një komision miks shqiptaro-italian. Për këtë u nënshkrua një kontratë për barakat e Sarandës dhe për ato të Gjirokastrës. Mirëpo kur komisioni nisi punën për realizimin e shitjes së barakave të Sarandës, nisi Lufta e Vlorës dhe akti i shitjes mbeti i papërfunduar. Pas Luftës doli në skenë një grup tregtarësh joshqiptarë grekofonë që pretendonte se i kishte blerë barakat e shtëpitë me rëndësi të asaj skele prej ushtrisë italiane. Ata po përpiqeshin ta shkelnin dhe zhvleftësonin urdhrin e Prefekturës duke u përpjekur të ofronin ryshfete të majme.

⁵⁵ *AQSH*, Fondi, *MPB*, viti 1920, dos.234, fl.113. Raport i prefektit të Gjirokastrës, Kol Tromara për *MPB*, 6 dhjetor 1920.

Gjithashtu në qytet ishte shtuar prezenca e influencës greke. Prefektura e Gjirokastrës informonte se "grekët e Sarandës janë gati të flakin qindra-mijëra franga me qëllim që të monopolizojnë godinat e sajë e të bëjnë punën e tyre politike"⁵⁶.

Ajo kërkonte prej qeverisë që të përdorte të gjitha mjetet e ligjshme dhe të vepronte pikërisht tani, për të mos lejuar që t'i ndryshohej fytyra shqiptare Sarandës, e cila duhej të mbetej një skelë thjesht shqiptare⁵⁷.

Po në këtë kohë qeveria shqiptare ndeshej edhe me problemin e rëndësishëm të sistemimit të refugjatëve çamë që ishin larguar prej shtëpive të tyre nga dhuna dhe reprezaljet e qeverisë greke. Kështu që në të njëjtën ditë, Këshilli i Ministrave vendosi që muhaxhirët çamë që gjendeshin në Vurg të Delvinës, të vendoseshin në godinat e barakat e Sarandës të zbrazura prej italianëve⁵⁸.

Megjithëkëtë situata ishte e vështirë. Saranda ishte e populluar në një shumicë të madhe prej elementit grekofon të ardhur nga Dropulli e Delvina dhe prej 30-40 grekëve. Tregtia e Sarandës ishte përgjithësisht në duart e grekofonëve dhe të grekëve. Disa myslimanë gjirokastritë e delvinjotë, të cilët në periudhën e fundit të regjimit turk kishin pasur një pozitë të mirë në tregtinë e Sarandës, kishin emigruar në kohën e pushtimit grek si rezultat i reprezaljeve greke⁵⁹. Nga humbja e kapitaleve që kishin pasur dhe ndofta edhe prej indiferencës që kishte treguar qeveria ata nuk ishin rikthyer më në Sarandë. Tregtia e Sarandës mbetej monopol i elementëve grekofonë dhe grekë me një eksperiencë të madhe dhe me kapitale të forta. Kështu Saranda, me gjendjen e popullsisë së atëhershme, duke u ndodhur në një distancë të shkurtër me Korfuzin, me marrëdhënie tregtare të stabilizuara me Greqinë dhe me një hinterland të populluar në mënyrë kompakte me popullsi grekofone që arrinte në afro 34 000 vetë, po merrte fizionominë e një qyteti grek⁶⁰.

Prefektura e Gjirokastrës i kërkonte qeverisë që ta vlerësonte drejt rëndësinë e Sarandës dhe të merrte masa për ndryshimin e gjendjes, duke e quajtur këtë problemin më të madh e më delikat të Shqipërisë Jugore.

⁵⁶ *Po aty.*

⁵⁷ *Po aty.*

⁵⁸ *Po aty*, fl.119. Njoftim i Ministrisë së Financave-Prefekturës së Gjirokastrës.

⁵⁹ *Po aty*, fl.61. Raport i Prefekturës së Gjirokastrës për MPB, 4 shtator 1921.

⁶⁰ *Po aty.*

Ajo sugjeronte që për t'ia arritur këtij qëllimi nuk duheshin kursyer dhe sakrificat më të mëdha financiare dhe të realizohej "ajo që gjuha klasike e botës së qytetëruar e quante kolonizim". Konkretisht prefektura propozonte mbrojtjen, përkrahjen dhe favorizimin për banim në Sarandë të popullsisë çame, pasi veprën njerëzore e legale të qeverisë për një stabilizim të këtij elementi në Sarandë nuk mund ta diskreditohte asnjë kritikë armiqtësore brenda e jashtë vendit. Por meqë ky element nuk kishte cilësi të larta psikologjike dhe nuk ishte i fortë e me mjete praktike për të zhvilluar tregti, duhej favorizuar edhe një grup tjetër shqiptarësh, pak a shumë të aftë për të ngritur qendra tregtie. Dhe meqë ky grup tregtarësh e kishte të vështirë të konkurronte kapitalin grek, ndihma nuk duhej të ishte vetëm morale, por edhe materiale. Për të mos bërë përshtypje të keqe tek grekofonët, këtij grupi duhej t'i financohej nga fondet e fshehta një pjesë e qirasë së godinave të Sarandës, që do të nxirreshin në ankand⁶¹.

S u m m a r y

THE EFFORTS FOR CONSOLIDATION OF NATIONAL IDENTITY DURING 1920-1924

During 1920-1940 it started the normal functioning of the Albanian state was faced with a number of problems to be dealt with. Therefore, it conducted a number of political and social reforms which served the fulfilment of the national identity of the Albanians.

The endeavours for the creation of the national religious institutions, the spread and consolidation of the Albanian schools in all of Albania and the closing of the foreign schools especially of those Greek in south Albania; the endeavours for the enhancements of the national identity in those regions where during the ottoman domination had been left significant traces of the foreign influences were great challenges in the fight for the construction of the nation-state.

This difficult battle that spent a great deal of the energy of the Albanian state and society was mostly undertaken under the pressure of the neighbouring countries Greece and Yugoslavia that followed a consisting policy of

⁶¹ *Po aty.*

obstruction to the consolidation of the state and national unity of Albania. This was the main reason that the results of these endeavours, although positive, were not definite and firm.